

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Nga Europa në Afrikë, precedentët numërohen me gishta: Sa i pazakontë është arrestimi i Vlora Hysenit në detyrë?                                                                                                                                                                        |
| ADRESA  | <a href="https://tpz.al/nga-europa-ne-afrike-precedentet-numerohen-me-gishta-sa-i-pazakonte-eshte-arrestimi-i-vlora-hysenit-ne-detyre-i333603">https://tpz.al/nga-europa-ne-afrike-precedentet-numerohen-me-gishta-sa-i-pazakonte-eshte-arrestimi-i-vlora-hysenit-ne-detyre-i333603</a> |
| BURIMI  | tpz.al                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 23 shtator 2026, 05:02:55 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 11:53:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 2c777053a5aab599b77fc43450b35cc2f46534e77f18c899c5a92c7d8c2f4c00 |
| TEKSTI     | c662f2958ea4ead9178ffdf2575f6a13a35614c2eca053fb5f9d4d08e115bd1e |
| PAMJA      | 4050e6d68143e7e77f2c7d50001568ecbe49ee9faa4317ab7f99a71c13a7d962 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | af0b7251e3c68080e32d8cd2f797b34c005e20afd50ab3891b2c55692849a999                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/af0b7251e3c68080e32d8cd2f797b34c005e20afd50ab3891b2c55692849a999>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FLASH!

16:44 Dyshohet se u ndërtua pa leje, sekuestrohet hoteli në Ksamil • 16:32 Makina përplasi motorin në zonën e Don Boskos, ndërron jetë 64-vjeçari • 15:44 Masa e arrest

AKTUALITET, 22 SEPTEMBER 2026, 13:53

# Nga Europa në Afrikë, precedentët numërohen me gishta: Sa i pazakontë është arrestimi i Vlora Hysenit në detyrë?

tpz.al TPZ



Shefa të shërbimeve sekrete që janë arrestuar pasi kanë lënë detyrën ka plot. Ka edhe raste kur drejtues të inteligjencës janë pezulluar apo shkarkuar dhe më pas janë arrestuar ose kanë përfunduar nën hetim.

Por është shumë më e vështirë të gesh një rast kur kreu i shërbimit sekret është ende në detyrë dhe institucionet e vendit të tij vendosin masë arresti ndaj tij.

Kjo është ajo që e bën të pazakontë rastin e drejtoreshës së SHISH, Vlora Hysenit, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe nëse e krahasojmë me atë që ka ndodhur në vende të tjera.

Me kërkesë të SPAK, Gjykata e Posaçme vendosi ndaj Hysenit masën "arrest në shtëpi", si dhe pezullimin nga detyra. Deri në atë moment, Hysenit ishte në krye të SHISH. Ajo nuk ishte shkarkuar dhe as pezulluar më parë.

Kur kërkon raste të ngjashme në botë, dallimet fillojnë të bëhen të dukshme.

Në Danimarkë, për shembull, Lars Findsen, drejtori i Shërbimit të Inteligjencës së Mbrojtjes, u arrestua në dhjetor 2021 nën dyshimet për nxjerrjen e informacioneve të klasifikuara.

Rasti bëri shumë bujë, por nuk është i njëjtë me atë të Hysenit. Findsen ishte pezulluar nga detyra që në gusht 2020. Kur policia daneze e arrestoi, kishte më shumë se një vit që nuk e drejtonte aktivisht shërbimin.

Një rast tjetër interesant është ai i Ruandës.

## ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë  
Nga Preç Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrezoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur  
Nga Mero Baze

## Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

## Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



## Moti

Tirana, Albania

## WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama

Në qershor 2015, gjenerali Karenzi Karake ishte drejtori në detyrë i Shërbimit Kombëtar të Inteligjencës dhe Sigurisë kur u arrestua në aeroportin Heathrow në Londër.

tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

Pra, bëhej fjalë vërtet për një shef aktiv të inteligjencës që arrestohej. Por ka një ndryshim thelbësor: nuk e arrestoi shteti i tij.

Karake u ndalua nga policia britanike në bazë të një urdhër-arresti europian të lidhur me një çështje të drejtësisë spanjolle. Autoritetet e Ruandës, përkundrazi, protestuan kundër arrestimit të tij.

Kur kërkimi kufizohet vetëm te rastet kur një shef aktiv i inteligjencës arrestohet nga institucionet e vendit të vet, precedentët bëhen shumë më të rrallë.

Një prej rasteve që i afrohet më shumë vjen nga Uganda.

Në vitin 2005, brigadieri Henry Tumukunde, në atë kohë një prej figurave drejtuese të aparatit të inteligjencës, u vendos në arrest shtëpie nga autoritetet e vendit të tij. Sipas raportimeve, banesa e tij u rrethua nga dhjetëra ushtarë dhe më pas ai kaloi një periudhë të gjatë në ndalim.

Edhe ky rast, megjithatë, ka pak të përbashkëta me mënyrën se si është zhvilluar çështja në Shqipëri. Tumukunde ishte një gjeneral dhe çështja e tij u zhvillua në një sistem ku ushtria kishte një rol të drejtpërdrejtë, shumë larg një procedure si ajo mes SPAK dhe Gjykatës së Posaçme.

Një rast tjetër u raportua në Siri në vitin 2015. Ali Mamlouk, një nga njerëzit më të fuqishëm të aparatit të sigurisë së Bashar al- Assadit, thuhej se ishte vendosur në arrest shtëpie ndërkohë që vazhonte të mbante postin.

Por historia mbeti e paqartë. Arresti nuk u konfirmua dot në mënyrë të pavarur dhe autoritetet siriane i kundërshtuan raportimet. Për këtë arsye, rasti i Mamlouk nuk mund të merret si një precedent i konfirmuar.

Krahasimet tregojnë se ajo që ka ndodhur me Hysenin nuk është pa asnjë precedent në botë, por është shumë larg të qenit diçka e zakonshme.

Nëse kërkon ish-drejtnes të inteligjencës që janë arrestuar, gjen shumë. Nëse përfshin drejtues që ishin pezulluar përpara arrestimit, gjen edhe raste në Europë. Por kur flasim vetëm për një drejtues që është ende aktiv në krye të shërbimit sekret dhe ndaj të cilit drejtësia e vendit të vet vendos masë arresti dhe pezullim nga detyra, lista shkurtohet ndjeshëm.

Në Europë, të paktën mes rasteve të dokumentuara publikisht, është e vështirë të gjendet një precedent që përputhet plotësisht me atë që ka ndodhur në Shqipëri.

Kjo, natyrisht, nuk thotë asgjë për fajësinë ose pafajësinë e Vlora Hysenit. Arresti në shtëpi është masë sigurie dhe përgjegjësi penale, duhet të provohet gjatë procesit. Por si ngjarje institucionale, rasti mbetet i pazakontë.

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:46

**Vendimi/ Apeli i Posaçëm lë në fuqi masën “arrest me burg” ndaj Ergys Agasit**

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:31

**Operacioni/ Përndoqi ish të dashurën, e dhunoi dhe e kanosi, arrestohet 33-vjeçari në Tiranë! Kërcënoi edhe punëdhënësin e saj për ta**

## hequr nga puna

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:22

Raporti/ Paradoksi i  
popullsisë: Në Shqipëri lindin  
më shumë djem por ka 28 mijë  
gra më shumë sesa burra

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:15

PROFIL/ Kush është Vlorë  
Hyseni, drejtuesja e SHISH që  
u pezullua nga detyra dhe u  
vendos nën arrest shtëpiak,  
me kërkesë të SPAK

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:09

Lezhë, Koçiu: Dyfishohen  
pagesat për fëmijët me aftësi  
të veçanta, nga tetori do të  
paguhen kontributet e  
kujdestarëve

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:59

Hyri për të grabitur në shtëpi,  
pronari vret shqiptarin, detaje  
nga jeta e 'dyfishtë' e Lazrit në  
Torino

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:46

Masa e SPAK për Vlorë  
Hysenin, Berisha: Nuk ndodh  
në asnjë vend që shefja e  
SHISH të jetë në shërbim të  
krimit! Vizitën e parë pas  
marrjes së detyrës e bëri në  
Beograd!

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:35

Skema/ Lehtësohen faturat e  
energjisë për klientët debitorë,  
ulen kamatëvonesat dhe  
firmosen 300 aktmarrëveshje  
në rajonin jugor

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:25

**Slloveni/ Ministri i Mbrojtjes, Nufi merr pjesë në Ministerialin e Bashkëpunimit të Mbrojtjes të Evropës Qendrore e Ballkanit Perëndimor**

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:15

**VIDEO/ Eurodeputetët në Zvërnec, priten me protesta nga banorët e zonës: Të dëgjohen shqetësimet tona për projektin**

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:03

**Operacion në Fier, Policia Rrugore në 'gjueti' të shoferëve problematikë! Monitoron me dronë dhe radarë parakalimet e gabuara**

AKTUALITET / 22 September 2026, 11:45

**Operacioni i SPAK shkakton debat në Komision, Kaso: Ka rënë shteti! Xhafaj: Arrestimi i zyrtarëve, shenjë e forcimit të shtetit të së drejtës**

AKTUALITET / 22 September 2026, 11:26

**Eurodeputetët "zbarkojnë" në Zvërnec, shoqërohen nga ligjvënës të maxhorancës e opozitës**

AKTUALITET / 22 September 2026, 11:19

**GJKKO caktoi masën "arrest shtëpie" e pezullim nga detyra për Vlora Hysenin, Bardhi: SHISH në duart e krimit të organizuar**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:50

**Arrestimi i drejtoreshës së SHISH-it dhe kontrollet në banesën e Ilir Prodës/ Shehaj: Po bie shteti kriminal i Edi Ramës, të japë dorëheqjen**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:43

**VIDEO/ Panik në det, gomonia pëson avari pranë Porto Palermos, shpëtohen mrekullisht 5 persona**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:36

**Operacioni i SPAK për dosjen  
'AKSHI', arrestohet një zyrtar i  
Policisë dhe një biznesmen!  
Kontrolle ushtrohen edhe në  
Durrës**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:29

**Bordi Transparencës vendos  
uljen e çmimit të naftës dhe  
benzinës! Ja me sa do të  
tregtohen**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.